



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 773/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Kërkesë Për Propozime” me Nr.REF- 34262-11-15-2017, me objekt : “Instalimi i sistemit per administrimin e taksave dhe tarifave vendore”, me fond limit 1.050.000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 27.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Ankimues:

“Image & Communication Development” shpk
Adresa: Rruga: “Themistokli Gërmenji”, Pallati Pegaso, Kati 2, Apt. 10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor

Bashkia Librazhd
Sheshi “Gjorg Golemi”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.11.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë Për Propozime” me Nr.REF- 34262-11-15-2017, me objekt : “*Instalimi i sistemit per administrimin e taksave dhe tarifave vendore*”, me fond limit 1.050.000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 27.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik “Image & Communication Development” shpk, rezulton se autoriteti kontraktor në datën 25.11.2017 ka anuluar procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm.

II.3. Në datën 30.11.2017 operatori ekonomik “Image & Communication Development” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

Neë datën 16.11.2017 nëpërmjet portalit *app.gov.al*, u informuam për procedurën e prokurimit me objektin e sipërcituar në të cilën u përgatitëm për të marrë pjesë. Më datën 25.11.2017 ditë e shtunë e pasuar nga 4 ditë pushim të tjera të administratës shtetërore, u informuam po nëpërmjet portalit *app.gov.al*, ndërsa po përgatiteshim të dërgonim ofertën tonë, për ndryshimin rrënjësor të kriterëve kualifikuese [për këtë procedurë të pashoqëruara me asnjë ndryshim në specifikime teknike të objektit të kontratës së prokuruar. Pa dashur të aludojmë mbi arsyet e këtij ndryshimi rrënjësor të

kritereve të kualifikimit një ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të ofertave dhe fillim të një periudhe 5 ditore pushimi me shumë mirësjellje kërkojmë vëmendjen tuaj si më poshtë:

Në shtojcën për modifikimin e kritereve kualifikuese datë 25.11.2017 thuhet:

Kriteret e vecanta për kualifikim modifikohen si më poshtë:

Ishte:

2.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO:

- Çertifikaten për menaxhimin e cilesise ISO 9001-2008 (Dizejnimi, ndertimi dhe mirembajtja e programeve kompjuterike dhe sistemeve të automatizuara të informacionit, e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikaten ISO,
- Çertifikate për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 270001 (Dizejnimi, ndertimi dhe mirembajtja e programeve kompjuterike dhe sistemeve të automatizuara të informacionit, e vlefshme)

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikaten ISO). Në rast se certifikatat e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Behet:

2.4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO

- Certifikaten 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilesise, me objekt: "Dizejnimi, ndertimi dhe mbirembajtja e programeve kompjuterike dhe sistemeve të automatizuara të informacionit". Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikaten ISO.
- Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatën ISO 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë së informacionit, në fushën e "Dizejnimi, ndertimi dhe mbirembajtja e programeve kompjuterike dhe sistemeve të automatizuara të informacionit". Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikaten ISO,

Në rast se certifikatat e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kundështojmë këtë ndryshim të papritur të kritereve referojmë VKM-në nr. 914 neni 30[...]

Duke qënë se versioni 2015 i certifikimit ISO 9001, po ashtu dhe ai i 2013 i certifikimit ISO 27001, kanë vetëm ndryshime të vogla dhe asnjë substanciale, dhe për më tepër këtë ndryshim ju nuk e shoqëroni me asnjë arsyetim apo ndryshim në specifikime teknike gjykojmë që ky kufizim vetëm për versionet e fundit të këtij certifikimi është diskriminues. Për më tepër të gjitha versionet e këtyre certifikimeve janë të pranuar në çdo procedurë prokurimi dhe kufizimi i tyre në mënyrë të papritur, pasi më parë vet ju keni pranuar të gjitha versionet e bën akoma më diskriminues këtë ndryshim momentin e fundit.

Kërkojmë të hiqet kufizimi i versioneve dhe të pranohen të gjitha versionet e certifikimeve ISO 9001 dhe ISO 27001. Në shtojcën për modifikimin e kritereve kualifikuese datë 25.11.2017 thuhet:

Ishte:

- 1(nje)specialist informaticien diplomuar ne degen e Informatikes,Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit ose Inxhinieri Informatike shoqeruar me diplomen,CV perkatese si dhe kontraten e punes I cili duhet te jete I certifikuar si "Administrues I bazave te te dhenave"per bazen e te te dhenave qe perdor zgjidhja e propozuar,si dhe te jete I certifikuar si "Solution Developer"per aplikacionet eeb ne teknologjine ku bazohet zgjidhja e ofruar.

Behet:

1. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij :

- Të paktën 1 (një) informaticien diplomuar ne degen e Informatikes,Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit ose Inxhinieri Informatike shoqeruar me diplomen,CV perkatese si dhe kontraten e punes i cili ka eksperience pune në zhvillimin e aplikimeve kompjuterike i cili duhet te jete certifikuar si:
 - Specialist i certifikuar per teknologjine ne te cilen bazohet zgjidhja e propozuar, dhe
 - Profesionist i certifikuar per teknologjine ne te cilen bazohet zgjidhja e propozuar
- Të paktën 1 (një) informaticien diplomuar ne degen e Informatikes,Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit ose Inxhinieri Informatike shoqeruar me diplomen,CV perkatese si dhe kontraten e punes i cili ka një eksperience pune në zhvillimin e aplikimeve kompjuterike i cili duhet te zoteroje certifikatat si me poshte:
 - Te jete i certifikuar si "Administrues i bazave te te dhenave" per bazen e te dhenave qe perdor zgjidhja e propozuar.
 - Te jete i certifikuar si "Solution Developer" per aplikacionet eeb ne teknologjine ku bazohet zgjidhja e ofruar.
 - Te jete i certifikuar per rrjetat kompjuterike per te garantuar konfigurimin korrekt te rrjetit kompjuterik. Te kete se paku certifikatat:
 - Cisco Certified Entry Netëorking Technician (CCENT)
 - Cisco Certified Netëork Associate Routing and Sëitching (CCNA)
- Të kete te punesuar te paktën 1 (një) financier me një eksperience pune prej 5 (pese) vite me njohuri mbi faturimet, taksat dhe tarifat e pushtetit vendor, kontabilizimet, etj shoqeruar me kontrate pune,CV.

Shtohet:

Operatori ekonomik, duhet të ketë patur të punësuar në stafin e tij:

- Të paktën 5 (pesë) specialistë të diplomuar në degët e Informatikës, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ose Inxhinieri Informatike, provuar kjo me diplomat ose vertetimet perkatese.

Së pari ndryshimi i kriterëve, nga kërkimi i një specialisti në kërkimin e 5 specialistëve, plus një financier, 10 ditë pas publikimit të kontratës dhe 1 ditë para përfundimit të afatit të saj ndonëse brenda të drejtës suaj ligjore është shumë i pazakontë. Ajo që ne kundështojmë këto ndryshime është si më poshtë:

Kërkesa që prej specialistëve të jetë i certifikuar CCENT dhe CCNA. Së pari në specifikimet teknike të kontratës së prokuruar nuk ka asnjë kërkesë që ka të bëjë me rrjete, router-a apo sëitch-e, madje as server. Përkundrazi në faqen 14 në zërin "Teknologjia bazë" bëhet me dije se Bashkia Librazhd e ka ngritur infrastrukturën IT bazuar mbi Microsoft Ëindoës. Referojmë nenin 30 të VKM-së nr. 914 pikën 2[...], kërkojmë heqjen e këtij kriteri duke qënë se në objektin e kontratës nuk ekziston asnjë kërkesë që të ketë lidhje me objektin e këtyre certifikatave. Gjithashtu duam t'ju sqarojmë se CCENT është një certifikim i ndërmjetëm sic sqaron vet lëshuesi i saj që shton rrugën drejt certifikimit CCNA, por dikush që ka CCNA nuk është i detyruar të ketë CCNET. Është njësoj sikur një personi që posedon certifikatë gjuhë të huaj nivelin "Avancuar" ti kërkon dhe certifikatë niveli "Mesatar". Kjo është thjesht për tu vënë në dukje që kush ka hartuar këto ndryshime, nuk ka pasur për qëllim verifikimin e aftësive profesionale të ofertiuesëve, por vështirësimin e pjesmarrjes në tender.

Po ashtu në lidhje me kërkesat për "Solution Developer" apo "Administrator i bazës së të dhënave", duke qënë se këto emërtime certifikimesh i përkasin lëshuesit Microsoft, dhe kjo përbën diskriminim, kërkojmë që të gjitha këto kërkesa të shoqëohen ose ekuivalente, sic veprojnë prej shumë kohësh, të gjitha autoritet kontraktore në kriteret e procedurave të tyre të prokurimit.

II.4. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik "Image & Communication Development" shpk, rezulton se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda afateve ligjore.

II.5. Në datën 06.12.2017 pala ankimuese "Image & Communication Development" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentimin si më poshtë vijon: [...]

Autoriteti kontraktor më datën 25.11.2017 depoziton një shtojcë për modifikime të dokumentacionit të tenderit. Brenda afateve ligjore në datën 30.11.2017 kemi paraqitur një ankesë pranë AK-së, si me mjete elektronike pranë portalit të APP-së edhe në rrugë postare përmes një shkrese me shkrim. Por kjo ankesë nuk është shoqëruar as me pezullimin e procedurës sipas parashikimit ligjor, as nuk kemi marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor mbi ankesën tonë brenda afateve kohore sic e parashikon ligji, ndërkohë që procedura nuk gjendet më në portalin e APP-së. Bashkëngjitur me këtë ankesë po ju dërgoj, më ankesën fillestare dërguar autoritetit kontraktor. [...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 16.11.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *“Kërkesë Për Propozime”* me Nr.REF- 34262-11-15-2017, me objekt : *“Instalimi i sistemit per administrimin e taksave dhe tarifave vendore”*, me fond limit 1.050.000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 27.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

III.1.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik *“Image & Communication Development”* shpk, rezulton se autoriteti kontraktor në datën 25.11.2017 ka anuluar procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm.

III.1.3. Në datën 30.11.2017 operatori ekonomik *“Image & Communication Development”* shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit

III.1.4. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik *“Image & Communication Development”* shpk, rezulton se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues brenda afateve ligjore.

III.1.5. Në datën 06.12.2017 pala ankimuese *“Image & Communication Development”* shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.6. Në nenin 24, pika 1 *“Anulimi i një procedure prokurimi”* të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a. Për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik; b. Nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve ligjore; c. Kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë; 5 d. Nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit; e. Nëse të gjitha ofertat e pranuar përbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar; f. Kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.”*

III.1.7. Në nenin 60 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, nxjerrë në zbatim të ligjit të mësipërm, është parashikuar shprehimisht: *“Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë: - objektin e prokurimit; - fondin e përllogaritur të vitit ushtrimor si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare; - llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj; - emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.*

Në nenin 42, pika 2 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se : *“[...]Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga njëoperator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. [...]”*

III.1.8. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ndodhet në një prej rasteve të parashikuara në nenin 24/1 të LPP-së për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik referuar LPP-së dhe konkretisht nenit 42 në të cilin parashikohet se : *“[...]Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, në rastin konkret referuar arsyes së anulimit të procedurës së prokurimit të parashtruar në sistemin elektronik të prokurimeve, Komisioni gjykon se një nga këto ndryshime në dokumentat e tenderit është edhe fondi limit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se fondi limit është një ndër elementët e rëndësishëm të një procedure prokurimi që përcaktohet që në nisjen e saj, në urdhërin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës si dhe hartohen dokumentat standarte të tenderit. Akoma më tej KPP gjykon se ndryshim është edhe rishikimi i specifikimeve teknike në këtë procedurë prokurimi nga ana e autoritetit kontraktor, pasi këto të fundit janë pjesë e dokumentave të tenderit, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.*

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Image & Communication Development” shpk., për procedurën e prokurimit “Kërkesë Për Propozime” me Nr.REF- 34262-11-15-2017, me objekt : *“Instalimi i sistemit për administrimin e taksave dhe tarifave vendore”*, me fond limit 1.050.000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 27.11.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Image & Communication Development” shpk
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1794 Protokolli; Datë 06.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha